



R E P U B L I K A E S H Q I P È R I S È

BASHKIA PUKË

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE PYJEVE E KULLOTAVE, DHE BUJQESISE

Lenda: Informacion mbi semundjen e geshtenjes

Drejtar: z.Artan Rama

Semundja e Grerezes se geshtenjes (Dryocosmus Kuriphilus Yasumatsu) prej 2 vitesh ka prekur edhe ne zonen e Pukes konkretisht fshati Kerthpule ne nje siperfaqe rreth 5 ha. Shkalla e prekjes eshte akoma ne fazat e para eshte prekur rreth 40%. Nuk kemi te dhena qe ka prekur ne zona te tjera ne territorin e Bashkise Puke. Per sa i perket raportit nuk kemi nje raport te detajuar me historikun e kesaj semundje ne kete territor duke qene se per ne eshte nje semundje e re e shfaqur vetem gjate 2 viteve te fundit. Persa i perket monitorimit vazhdon te monitorohet si semundje por nuk kemi nje dokument perfundimtare theksojme se luftimi e kesaj semundje duke marre eksperiencat e rajoneve te tjera duhet te behet me lufte biologjike. Sic e thame edhe me siper duke qene se eshte nje semundje e re nuk kemi kryer investime ne luftimin e kesaj semundje. Jemi ne fazat e para te preqatitjes se nje stategjie per parandalimin e avancimit te semundjes bashki me Ministrine e Bujqesise dhe Organizaten FAO. Persa i perket demit ekonomik te shkaktuar nuk eshte i madh sepse semundja ka prekur vetem zonen e Kerthpules.